



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:067613

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06379973

C.nr.420/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve L. H., A. I. N. P. dhe R.U., të gjithë nga M., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Leutrim Ademi avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore-Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë, me objekt kontesti kompensimin e shtesës së inflacionit në pagë, jashtë seancës me datë 30.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve L. H., A. I. N. P. dhe R.U., të gjithë nga M.
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, që paditësit në emër të shtesës së inflacionit në pagë t'i kompensojë si në vijim:

i. Paditësit L. H.:

- Për periudhën kohore Janar – Dhjetor ..., shumën prej ...€ (...);
- Për periudhën kohore Janar – Tetor ..., shumën prej ...€ (...);
- Për periudhën kohore nga data ... deri më datë ..., shumën prej ...€ (...) apo shumën e përgjithshme prej ...€ (...).

ii. Paditëses A. I.:

- Për periudhën kohore Janar – Dhjetor ... shumën prej ...€ (...);
- Për periudhën kohore Janar – Tetor ... shumën prej ...€ (...);
- Për periudhën kohore nga data ... deri më datë ..., shumën prej ...€ (...0 apo shumën e përgjithshme prej ...€ (...).

iii. Paditëses N.P.:

- Për periudhën kohore Janar – Korrik ..., shumën prej ...€ (...).

iv. Paditësit R. U.:

- Për periudhën kohore Janar – Qershor ... shumën prej ...€ (...).

III. DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, që paditëseve t'ua paguajë kamatën në lartësi prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë ... e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej ...€ (...), të gjitha në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZHET kërkesëpadia e paditësve për kompensimin në emër të shtesës së inflacionit në pagë dhe atë: për paditësin L. H. në shumën e kërkuar prej ...€ (shtatëqind e tridhjetë e gjashtë euro e njëzet e dy cent), përtej shumës së gjykuar në shumë prej ...€ (shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e katërbëdhjetë cent); për paditësen A. I. në shumën e kërkuar prej ...€ (shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e dyzet një cent), përtej shumës së gjykuar në shumë prej ...€ (shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e katërbëdhjetë cent); për paditësen N. P. në shumën e kërkuar prej ...€ (shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e njëzet e një cent), përtej shumës së gjykuar në shumë prej ...€ (shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e katërbëdhjetë cent); për paditësin . U. në shumën e kërkuar prej ...€ (...), përtej shumës së gjykuar në shumë prej ...€ (...); si në pikën II të dispozitivit si e pabazuar.

V. REFUZHET kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumën e kërkuar prej ... (treqind euro), përtej shumës së gjykuar në shumë prej ...€ (... euro), si në pikën III të dispozitivit, si e pabazuar.

A r s y e t i m

I. Paditësit L. H., A. I. N. P. dhe R.U. të gjithë nga M. përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë ..., pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore-Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë, për kompensimin e shtesës së inflacionit në pagë, të cilën pastaj e ka zgjeruar në kuptim subjektiv me parashtrësën e datës ..., duke përfshirë si paditës edhe N. P. nga M., për ta precizuar përfundimisht me parashtrësën e datës ..., ku ka kërkuar kompensim edhe për paditësin R. U. Në padi dhe në precizim të padisë, paditësit kanë theksuar se të njëjtit janë në marrëdhënie pune te e paditura. Paditësit duke u mbështetur në dispozitën e nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit, dhe meqë e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj tyre, kanë kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurën Komuna e Mitrovicës Jugore-Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë, që paditësit në emër të inflacionit në pagë, t'i kompensojë si në vijim:

Për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021:

- Për paditësin L. H., paga ...€ x .. muaj ...€ x ..% = ...€;
- Për paditësen A. I., paga ...€ x .. muaj = ...€ x ...% = ...€;
- Për paditësen N. P., paga ...€ x ... muaj = ...€ x ...% = ...€;
- Për paditësin R. .U paga ...muaj = ...€ x ...% = ...€.

Për periudhën Janar – Nëntor ...:

- Për paditësin Lulzim Hajzeri, paga ...€ x ... muaj = ...€ x ...% = ...€;
- Për paditësen Arta Ibrani, paga ...€ x .. muaj = 5...€ x ...% = ...€.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar duke i specifikuar dhe atë ...€ për padi dhe ...€ për taksë gjyqësore.

E paditura Komuna e Mitrovicës Jugore-Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë, përmes përgjigjes në padi e ka pohuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sa i përket kompensimit në emër të inflacionit në pagë, mirëpo e ka kundërshtuar kompensimin për muajt Janar ... dhe Nëntor ... me arsyetimin se paditëset gabimisht kanë llogaritur shumat të cilat mund t'u takojnë pasi që kanë llogaritur muajin Janar të vitit ... para hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive dhe muajin Nëntor të vitit ..., pas shkëputjes së Kontratës Kolektive të Arsimit, kërkesë kjo e cila nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së bazës ligjore. Poashtu e ka kundërshtuar kërkesën e

paditësve për kompensimin e shpenzimeve për parashtrimin e kërkesës të e paditura dhe për parashtrësën për precizim të padisë, me arsyetimin se një kompensim i tillë nuk parashihet me Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditëseve të aprovohet pjesërisht si e bazuar sa i përket kompensimit të inflacionit në pagë ndërsa sa i përket pjesës së kontestuar, kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimi jashtë seancës, dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Në rastin konkret gjykata gjeti se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit L. H., A. I. N. P. dhe R.U, janë në marrëdhënie pune tek e paditura.

Poashtu mes palëve nuk rezultoi kontestuese fakti se paditësve u takon kompensimi në emër të shtesës së inflacionit në pagë, por kontestuese ishte lartësia e kompensimit respektivisht periudha për të cilën paditësve u takon kompensimi në emër të shtesës së inflacionit në pagë.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë për paditëset L. H., A. I. N. P. dhe R.U, në vitin ... ka qenë ...€. Poashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin ... ka qenë ...%, për vitin ...ka qenë ...%, për vitin ... ka qenë ...%, ndërsa për vitin ... ka qenë ...%. Provave të lartcekura gjykata i'u fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e datës 18.04.2017 dhe asaj të

datës 22.01.2021, të cilat në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe atë Nr. 214/2023 të datës 09.10.2023.

Mbi bazën e të lartëcekurave, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes zingjyrore të inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti ... deri në vitin ... (brenda kërkesës së paditësve) sipas përlllogaritjes si në vijim:

Për periudhën Janar - Dhjetor ..., gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë ...%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësve L. H., A. I., e cila në vitin ... ka qenë ...€, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën ...mujore në total të jetë ...€, apo ...€ për muaj (...*3..%*...=....).

Për periudhën Janar – Korrik 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditëses Nazmije Peci e cila në vitin 2021 ka qenë 459.00€, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 7 mujore (aq sa ka kërkuar me parashtrësën për precizim) në total të jetë 109.24€, apo 15.60€ për muaj ($459.00 * 3.4\% * 7 = 109.24$).

Për periudhën Janar – Qershor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësin Rasim Uka e cila në vitin 2021 ka qenë 459.00€, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 6

mujore (aq sa ka kërkuar me parashtrësën për precizim) në total të jetë ..€, apo ...€ për muaj (...*...%*..=...).

Për periudhën Janar – Tetor ... gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësve L.H., A. I., sipas shtimit dinarik e cila në vitin ...do të duhej të ishte ...€, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën ... mujore në total të jetë ...€, apo€ për muaj (...*...%*..=...).

Për muajin Nëntor ..., gjykata pati parasysh që nga ... ditë pune sa ka pasur ky muaj, paditësit deri më datë ... kanë pasur ... ditë pune, shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë ...%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësve L. H., A. I. e cila për ... ditë pune ka qenë ...€, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën ... ditore në total të jetë ...€, apo ...€ për ditë (...*..% =.../..=...).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësit janë të punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data Janar – Dhjetor ... dhe Janar – Nëntor ..., në pagën e paditësve nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar lartësinë e kërkesëpadsisë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjen se e paditura e ka pohuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve ndërsa e ka kontestuar kompensimin për muajin Janar të vitit ... dhe muajin Nëntor të vitit ... me arsyetimin si në përgjigje në padi.

Në rastin konkret pavarësisht se e paditura e ka pohuar një pjesë të kërkesëpadsisë së paditësve, gjykata nuk mund të nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit konform dispozitës së nenit 148 par.1 të LPK-së, sepse nga shikimi në shkresat e lëndës gjykata gjen se paditësit kompensimin në emër të shtesës së inflacionit e kanë kërkuar në lartësi të pagës neto dhe jo në lartësi të pagës bazë, e që është në kundërshtim me nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit dhe Listën e

Pagave të cilën e kanë bashkangjitur vetë paditësit, e në kuptim të dispozitës së nenit 148 par.2 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata nuk e jep aktgjykimin në bazë të pohimit, edhe pse janë plotësuar kushtet e nevojshme, po që se konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i nenit 3 të këtij ligji)”*, për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 të kësaj dispozite ligjore është përcaktuar se: *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës, se paditësit gabimisht kanë llogaritur muajin Janar të vitit 2021, sepse në këtë kohë nuk ka qenë fuqi të Kontrata Kolektive e Arsimit, por gjeti se një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës Nr.40/2023, i datës 27.02.2023, në pikën IV (katër) të tij ka përcaktuar se: *“Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 18.04.2017, aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017, e deri me datë 21.01.2021”*, ndërsa Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës Nr.214/2023, i datës 09.10.2023, në pikën III (tre) të tij ka përcaktuar se: *“Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri me datë 21.11.2022”*, pra, nuk ekziston vakumi ndërmjet dy kontratave kolektive të arsimit, andaj, edhe kundërshtimet e të paditurës për muajin Janar 2021, në këtë drejtim u vlerësuan si të pabazuara për të vendosur ndryshe.

Për gjykatën rezultoi si i pabazuar edhe kundërshtimi i të paditurës i dhënë në përgjigje në padi, se paditësve nuk u takon kompensimi i shtesës së inflacionit në pagë për muajin Nëntor Gjykata vlerëson se paga e paditësve për ditët sa ka qenë në fuqi kontrata nuk mund të mbetet e zhvlerësuar për ...% të inflacionit sa ka qenë në vitin ..., sepse për ... ditët e punës të muajit Nëntor, paditësve duhet t’u kompensohet shkalla e inflacionit në pagë, ndërsa për 7 ditët pas datës ..., kërkesëpadia e paditësve duhej refuzuar, sepse të gjitha kërkesat e të punësuarve që

kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar sipas kësaj kontrate, dhe atë deri me datë ..., kur edhe e njëjta është shkëputur.

Lidhur me lartësinë e kamatës, gjykata vendosi në bazë të dispozitës së nenit 382 të LMD-së, e cila përcakton se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë më datë ...

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform dispozitës së nenit 449 lidhur me nenin 452 dhe 463 të LPK-së, pasi që gjeti se paditësit të njëjtat i kanë specifikuar me parashtrësën e datës Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumën prej ...€ dhe taksës gjyqësore për padi në shumë prej ...€.

Gjykata refuzoi kërkesën e paditësve për kompensimin e procedurës në shumën e kërkuar prej 300.00€, përtej shumës së gjykuar prej ...€, pasi që në emër të taksës gjyqësore paditësit kanë paguar shumën prej ...€ dhe jo shumën prej ...€, ashtu siç pretendojnë në padi.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimet e së paditurës se paditësve nuk u takon kompensimi për kërkesën e ushtruar te e paditura për kompensim dhe për parashtrësën për precizim të padisë por gjeti se këto shpenzime nuk janë kërkuar dhe as nuk janë specifikuar nga paditësit andaj edhe nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi i tyre.

Nga sa u tha më lart, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.420/2022, më datë 30.10.2024

G j y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.